Republika e Kosovës

MINISTRIA E FINANCAVE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2015

mf.rks-gov.net

Agjenda legjislative

Nga gjithsej 76 projektligje të miratuara nga Qeveria, 17 prej tyre janë përgatitur nga Ministria e Financave, që është 22% e programit legjislativ të realizuar nga Qeveria gjatë këtij viti. (në vitin 2014 Ministria e Financave ka përgatitur vetëm 7 projektligje).

Sa i përket akteve nënligjore, janë përgatitur 9 Udhëzime Administrative dhe 1 Rregullore:
• 6 Udhëzime Administrative të Ministrisë së Financave janë miratuar nga Qeveri,
• 3 Udhëzime Administrative janë miratuar nga Ministri,
• 1 Rregullore është miratuar nga Ministri.

Ligjet dhe rregulloret më të rëndësishme:
• Pakoja fiskale: Ligjin mbi TVSH-në, Ligjin mbi të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjin mbi të Ardhurat Personale.
o Heqja e TVSH-së për lëndën e parë dhe makineritë prodhuese, për teknologjinë informative,
o Përshkallëzimi i TVSH-së,
o Uljen e pragut të TVSH-së,
o Është rregulluar tregu i barnave duke hequr taksën doganore për importin e barnave pavarësisht vendit nga vijnë,
o Është hequr taksa doganore për produktet e energjisë që përdoren në procesin e prodhimit,
o Është liberalizuar me udhëzim administrativ tregu për furnizim me arka fiskale.

• Ligji për Prokurimin Publik:
o Kjo është reforma më e thellë në prokurimin publik,
o Aplikimi prokurimit elektronik,
o Ndarja e kontratave në loto për të mundësuar pjesëmarrjen e firmave të vogla në prokurim,
o Organizata buxhetore me më pak se 50 punëtorë nuk mund të kryejnë vetë prokurime,
o Vendosen kushte specifike në tenderime për të mundësuar punësimin e personave të papunë, me aftësi të kufizuar, nxitja e barazisë gjinore, nxitja e diversitetit etnik etj.,
o Organizata e shoqërisë civile mund të marrin pjesë në prokurime,
o Të gjithë zyrtarët e prokurimit kalojnë nëpër trajnime gjatë vitit të parë,
o Të gjitha këto masa pritet të rrisin efikasitetin e shpenzimeve publike duke reduktuar me:
 12% koston në projekte që tenderohen dhe
30% zvogëlim të shpenzimeve administrative të zyrave të prokurimit.

• Ligji për Menaxhimin e Financave Publike:
o Klauzola e investimeve: hyrja në kredi ndërkombëtare për financim të projekteve kapitale,
o Menaxhimi më i mirë i buxheteve komunale pas datës 1 mars nëse nuk aprovohen buxhetet komunale,
o Lidhja e rritjes së pagave në sektorin publik me rritjen nominale të Bruto Prodhimit Vendor.

• Ligji për faljen e borxheve:
o përcaktohen kriteret dhe procedurat për faljen e borxheve për personat fizik dhe juridik deri më 31.12.2008.
o 680 milion borxhe do të falen, 90% nga përfituesit janë qytetarë, kryesisht raste sociale.

Kontributi i Ministrisë së Financave në mbledhjet e Qeverisë dhe të trupave të tjerë Qeveritarë dhe të Kuvendit

Gjatë këtij viti, Qeveria e Kosovës ka mbajtur 64 mbledhje të rregullta. Në këto mbledhje janë trajtuar 569 pika të rendit të ditës, prej të cilave 99 pika kanë qenë të Ministrisë së Financave, që është 17% e të gjitha pikave të rendit të ditës të trajtuar nga Qeveria gjatë këtij viti.

Ministria e Financave ka proceduar 27 çështje të ndryshme (si projektligje, vendime etj.) në Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës.

Po ashtu, në Komitetin për Partneritet Publik-Privat, Ministria e Financave ka proceduar 54 pika të rendit të ditës ku përfshihen kryesisht projekte për partneritet publiko privat nëpër komuna, rregullore të ndryshme dhe vendime.

Të hyrat nga Doganat dhe Administrata Tatimore

Krahasuar me vitin e kaluar, sivjet kemi 9% më shumë të hyra nga Dogana e Kosovës dhe 12% më shumë të hyra nga Administrata Tatimore. Në total, gjatë këtij viti mblidhen 113 milion euro më shumë se vitin 2014.

	2012	2013	2014	2015
Të hyrat nga Dogana dhe ATK	**1,126,605,000 €**	**1,139,516,000 €**	**1,172,535,000 €**	**1,286,000,000 €**
- Dogana	842,787,000 €	834,080,000 €	868,570,000 €	946,000,000 €
- ATK	283,818,000 €	305,436,000 €	303,965,000 €	340,000,000 €
Rritja vjetore në %		**1%**	**3%**	**10%**
- Dogana		-1%	4%	9%
- ATK		8%	0%	12%
Rritja në euro		**12,911,000 €**	**33,019,000 €**	**113,465,000 €**
- Dogana		-8,707,000 €	34,490,000 €	77,430,000 €
- ATK		21,618,000 €	-1,471,000 €	36,035,000 €


Të hyrat nga Dogana dhe Administrata Tatimore
(të hyrat vjetore)
1,300,000,000 €
1,250,000,000 €
1,200,000,000 €
1,150,000,000 €
1,100,000,000 €
1,050,000,000 €
1,000,000,000 €
1,126,605,000 €
1,139,516,000 €
1,172,535,000 €
1,286,000,000 €
2012
2013
2014
2015


Të hyrat nga Dogana dhe Administrata Tatimore
(rritja e të hyrave vjetore)
120000000
100000000
80000000
60000000
40000000
20000000
0
12,911,000 €
33,019,000 €
113,465,000 €
2012
2013
2014
2015

Dogana e Kosovës

Dogana e Kosovës gjatë vitit 2015 ka arritur performancë dukshëm më të mirë krahasuar me vitin 2014. Dogana sivjet mbledh 946 milion euro, që është 9% më shumë se vitin paraprak, me gjithë ndryshimin në politikat fiskale.

	2012	2013	2014	2015
Të hyrat vjetore në euro	842,787,000 €	834,080,000 €	868,570,000 €	946,000,000 €
Rritja vjetore në %		-1%	4%	9%
Rritja vjetore në euro		-8,707,000 €	34,490,000 €	77,430,000 €





Është rritur kontrolli dhe lufta kundër kontrabandës. Kemi ndarë një shumë prej 40,000 euro për të mbështetur ekipet që luftojnë kontrabandën në gjithë Kosovën. Me këtë rast unë falënderoj zyrtarët doganorë për punën e jashtëzakonshme që po bëjnë në këtë drejtim.

Sivjet kemi përmirësuar dukshëm procedurat doganore dhe kemi lehtësuar kushtet e të bërit biznes. Drejtori i Doganës ka miratuar këto udhëzime dhe vendime:

1. Udhëzimi Administrativ për shpenzimet e transportit,
2. Është funksionalizuar dhoma qendrore për pranim të deklaratave unike doganore në Prishtinë.
3. Është aplikuar garancioni edhe nga kompanitë e sigurimeve,
4. Po përgatitet aplikacioni për aplikim dhe shitje on-line të mallrave të konfiskuara,
5. Po bëhet pranimi i deklarimeve nga vendkalimet kufitare të veriut në dhomën qendrore në Prishtinë,
6. Është avancuar tranziti i përbashkët me Doganat e Shqipërisë,
7. Po punohet me deklarata elektronike dhe dokumentet tjera (Paperless),
8. Po punohet në aplikimin e pagesave elektronike (E-payment),

Po punohet në udhëzimin administrativ për procedurën e thjeshtëzuar të zhdoganimit të mallrave.

Administrata Tatimore

Administrata Tatimore ka arritur rezultate të shumë të mira këtë vit. Nga trendi negativ që ka pasur vitin 2014, rritja e të hyrave sivjet pritet të jetë për 12% më e lartë, apo për 36 milion më shumë.

	2012	2013	2014	2015
Të hyrat vjetore	283,818,000 €	305,436,000 €	303,965,000 €	340,000,000 €
Rritja vjetore në %		8%	-0.05%	12%
Rritja në mil euro		21,618,000 €	-1,471,000 €	36,035,000 €





Është aplikuar nga prilli projekti i rimbursimi të kuponëve fiskal. Gjatë kësaj periudhe, janë rimbursuar mjete nga kuponët fiskal në vlerë prej 737,750 euro për 45,355 qytetarë. Kjo ka ndikuar në uljen e informalitetit.

Pas hyrjes në fuqi të pakos së re fiskale:
• 152 kompani kanë marrë autorizime për lirim nga TVSH-ja në import të lëndës së parë për prodhim,
• 163 kompani kanë shfrytëzuar mundësinë e importit pa TVSH të makinerisë prodhuese dhe teknologjisë informatike.
• Si rezultat, importuar rreth 30 milion euro vlerë të makinerisë prodhuese të cilat kanë përfituar mbi 5 milion euro lirime nga TVSH-ja që mund të konsiderohet si kontribut i Qeverisë së Kosovës në nxitjen e investimeve.

Administrata Tatimore ka lehtësuar kushtet e të bërit biznes:
• Janë miratuar këto udhëzime administrative:
o Udhëzim Administrativ për shfrytëzimin e pajisjeve elektronike dhe sistemeve fiskale,
o Udhëzim Administrativ për Tatimin në të Ardhura Personale,
o Udhëzim Administrativ për Tatimin në të Ardhura ne Korporata
o Udhëzim Administrativ për Tatimin në Vlerën e Shtuar.
• Janë në përfundim këto udhëzime administrative:
o Udhëzim Administrativ për Pushimet Tatimore,
o Udhëzim Administrativ për Transferimin e Çmimeve.

Unifikimi i Doganës dhe ATK- së

Në programin e Qeverisë së Kosovës 2014-18, është planifikuar që të bëhet unifikimi i Doganave dhe Administratës Tatimore në një Agjenci të përbashkët të të hyrave.

Qeveria, me propozim të Ministrisë së Financave, ka miratuar planin inicial për këtë reformë të madhe.

Është themeluar Grupi Koordinues me përfaqësues të Doganës dhe Administratës Tatimore dhe ekspertë të jashtëm dhe vendorë. Ky projekt është duke u mbështetur me asistence teknike dhe financiare nga donatoret si Fondi Monetar Ndërkombëtar, GIZ nga Qeveria e Gjermanisë dhe Qeveria e Estonisë.

Planifikohet që procesi i bashkimit të Doganës dhe Administratës Tatimore të përfundojë në fund të vitit 2016 dhe Agjencia e të Hyrave të fillojë punën më 2017.

Menaxhimi i borxhit publik dhe zhvillimi i tregut të letrave me vlerë

Në fillim të këtij viti është miratuar Strategjia për Borxhin Publik. Veprimet që janë ndërmarrë gjatë këtij viti kanë qenë në linjë me këtë strategji.

Borxhi i përgjithshëm i Kosovës është 728 milion euro, që është rreth 12.6% e Bruto Prodhimit Vendor që ka Kosova. Kjo përqindje është mjaft e ulët krahasuar me vendet në regjion.

Kemi mirëmbajtur dhe kemi paguar rregullisht pa asnjë vonesë borxhin publik të Kosovës. Për më tepër, është përmirësuar struktura dhe karakteristikat e borxhit publik të Kosovës:
• rreth gjysma e borxhit është borxh i brendshëm, tek bankat dhe subjektet vendore, që është krijuar përmes lëshimit të letrave me vlerë. Vetëm gjatë këtij viti janë ngritur 120 milionë euro shtesë borxh publik nga letrat me vlerë.
• Me kalimin e kohës, letrat me vlerë janë me afat gjithnjë e më të gjatë dhe kjo e përmirëson stabilitetin buxhetor.
• Norma e baraspeshuar e interesit për borxhin publik është vetëm 2.5%.
• Vetëm 13.7% e borxhit nuk është në euro, që është ekspozim mjaft i ulët ndaj rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit (kjo valutë është SDR nga kredia që kemi me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe është relativisht stabile).
• Rreth 86% e borxhit ka normë fikse të interesit.

Sivjet kemi ndërmarrë një reformë të madhe sa i përket borxhit publik. Me miratimin e ndryshimeve në ligjin për menaxhimin e financave publike, tani Kosova është e gatshme të hyjë në kredi zhvillimore tek institucionet financiare ndërkombëtare për të financuar projekte të mëdha kapitale, siç janë projektet e sistemeve të ujitjes së tokave bujqësore, hekurudhat, rrjeti energjetik dhe projekte të tjera strategjike.

Kosova është në pozitë të volitshme sa i përket borxhit publik, prandaj ka hapësirë të mjaftueshme për të marrë kredi zhvillimore.

Menaxhimi i buxhetit gjatë këtij viti dhe kursimet buxhetore

Buxheti i këtij viti po ekzekutohet në nivel prej 95.5% që është shkallë mjaft e lartë e ekzekutimit. Viti përmbyllet me deficit sipas rregullës fiskale dhe në përputhje me marrëveshjen që kemi me Fondin Monetar.

Krahasuar me buxhetin fillestar, kemi kursime vetëm në paga/mëditje dhe mallra/shërbime prej 40 milion euro:
• 25 milion euro në paga/mëditje, për shkak të racionalizimit të shpenzimeve në mëditje, shtesa të ndryshme etj.,
• 15 milion euro në mallra dhe shërbime, pasi janë reduktuar dukshëm shpenzimet e panevojshme, janë hequr nga përdorimi 177 vetura zyrtare etj.

Në anën tjetër, ka filluar pagesa e përvojës së punës për të gjithë të punësuarit në sektorin publik. Si rezultat, janë rritur pagat mesatarisht nga 3% deri në 22%. Kjo rritje e pagës ka kushtuar rreth 30 milion euro shtesë që nuk kanë qenë të planifikuara, por që kanë ardhur nga kursimet.

Kursimet e bëra na kanë mundësuar që të rrisim nga muaji nëntor asistencën sociale me 25% për 27 mijë familje që janë në këtë skemë.

Për herë të parë kemi filluar me pagesën e pensioneve për veteranën e luftës të UÇK-së në vlerë prej 170 euro në muaj.

Kemi vendosur kontroll të plotë sa i përket ë krijimit të obligimeve kontraktuale nga organizatat buxhetore. Asnjë tender nuk mund të shpallet dhe asnjë kontratë nuk mund të lidhet nëse nuk janë mjetet e zotuara. Ne kemi trashëguar 163 milion euro borxhe, dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre kanë qenë obligime të krijuara duke hyrë në obligime kontraktuale pa zotim të mjeteve.

Kemi bërë ndërlidhjen e plotë në mes të Thesarit në Ministrinë e Financave, organizatës buxhetore dhe Komisionit Rregulltativ të Prokurimit Publik. KRPP nuk e shpall asnjë tender nëse organizata buxhetore nuk merr konfirmimin nga Thesari se janë mjetet për atë projekt janë të planifikuara në buxhet dhe janë të zotuara në sistem për atë projekt.

Kemi ndryshuar rregulloren për shqyrtimin e implikimit financiar të akteve ligjore dhe nënligjore që miratohen. Është vendosur një mbikëqyrje e plotë në këtë drejtim, që siguron se nuk miratohen akte ligjore dhe nënligjore që nuk kanë mbulesë adekuate buxhetore.

Programi me Fondin Monetar Ndërkombëtar

Një arritje e konsiderueshme ishte hyrja në program 22 mujor me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Programin parasheh shumë reforma fiskale, ekonomike e financiare, me objektivin kryesor ruajtjen dhe përmirësimin e mëtutjeshëm të stabilitetit buxhetor dhe financiar, dhe rritjen më të madhe të ekonomisë.

Ky është ndër programet e rralla që ka Fondi Monetar me ndonjë vend, jo për shkak të problemeve me buxhetin që ka Kosova, por për të na përkrahur në agjendën zhvillimore përmes reformave strukturore.

Si rezultat i zbatimit të suksesshëm të këtyre reformave nga Qeveria e Kosovës, Fondi Monetar tanimë ka disbursuar pjesën e parë të financimit prej 35 milion euro, ndërsa priten edhe disbursime tjera në muajt e ardhshëm. Vlera totale e financimit përmes këtij programi arrin në 185 milion euro.

Hyrja në program me Fondin Monetar dhe implementimi i tij me sukses, pos që ka ndikuar në implementimin e reformave, ka ndikuar edhe në përmirësimin e reputacionit të Kosovës në raport me partnerët e jashtëm dhe investitorët, meqë një program i tillë e shton kredibilitetin e qeverisjes dhe të institucioneve.

Përmes këtij programi ne kemi ndryshuar rregullën fiskale që ka qenë shumë kufizuese për financimin e projekteve të mëdha kapitale. Nga viti i ardhshëm, ne do të fillojmë negociatat me institucione financiare ndërkombëtare për të financuar projekte të mëdha kapitale përmes kredive me kushte të volitshme.

Reformat ekonomike dhe efektet e tyre

Kjo është qeveria e parë që ka filluar punën me Program Qeverisës katërvjeçar të aprovuar dhe të proceduar në Kuvend. Ky program përmban objektivat konkrete që ka ky koalicion qeverisës.

Në fillim të këtij viti, për herë të parë kemi aprovuar "Programin për Reforma Ekonomike" dhe e kemi dërguar në Komisionin Evropian. Ky është një dokument që elaboron reformat afta-mesme ekonomike e fiskale që do të ndërmarrë Qeveria.

Po finalizohet Strategjia Zhvillimore Kombëtare, si dokumenti më i rëndësishëm që prezanton vizionin tonë si shoqëri, politikat ekonomike dhe reformat në të gjitha fushat. Në këtë strategji përfshihen edhe kostot e masave dhe aktiviteteve, në mënyrë që të kemi një dokument të implementueshëm në praktikë e jo një dokument të dëshirave.

Kemi përgatitur Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-18 në format të rishikuar, duke përfshirë edhe analizën e borxhit publik që e mbështet zbatimin e kësaj kornize. Ky është një dokument i politikave dhe shpenzimeve afat-mesme të Qeverisë, që i ka parapri më pas përgatitjes së Buxhetit për vitin 2016.

Bazuar në reformat e ndërmarra për një ambient më të mirë ekonomik, këtë vit ne presim një rritje më domethënëse ekonomike, me një normë prej rreth 3.8%, nga 1.2% sa ishte në vitin 2014.

Sivjet investimet e jashtme janë trefishuar krahasuar me vitin e kaluar, që tregon për një rritje të besueshmërisë në institucionet e vendit dhe politikat reformuese.

Është themeluar më 18.03.2015, Grupi Këshillëdhënës për Tatime dhe Dogana me përfaqësues edhe të odave ekonomike. Grupi ka mbajtur 4 takime të rregullta dhe 25 konsultime individuale me anëtarët e grupit si dhe bizneset e organizuara ne asociacione të ndryshme biznesore. Janë shqyrtuar kërkesat dhe ankesat e ndryshme të asociacioneve, shoqatave dhe bizneseve individuale.

Marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim financiar, teknik dhe ekonomik

Kemi nënshkruar 10 marrëveshje për bashkëpunim financiar në vlerë totale prej 143 milion euro, prej të cilave:

- 107 milion janë kredi dhe
- 36 milion euro grante.

Marrëveshjet të cilat vlen të theksohen janë :

1. Marrëveshja për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10 me BERZH në vlerë 39.9 milion euro;
2. Marrëveshja për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10 me Bankën Evropiane për Investime në në vlerë 42 milionë euro;
3. Marrëveshja për Bashkëpunim Financiar me Qeverinë Federale të Gjermanisë për vitin 2014.

4. Marrëveshja me Qeverinë Austriake nga programi për kredi të Buta për Projektin "Modernizimi i shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës".
5.Marrëveshja për fushën e arsimit me Bankën Botërore.

Ministria e Financave ka arritur gjatë këtij viti të marrë përsipër negocimin e Marrëveshjes Kornizë për bashkëpunim ekonomik me Qeverinë Gjermane. Kjo marrëveshje zëvendëson marrëveshjet e ish-Jugosllavisë dhe vendos bazë të re më të afërt të bashkëpunimit teknik dhe financiar të Kosovës me Gjermaninë.

Gjatë vitit 2015 Ministria e Financave arritur që të hap negociatat për eliminimin e tatimit të dyfishtë me vendet ku kemi diasporë të madhe, si në Austri dhe Zvicër.

Këshilli Kombëtar për Investime

Ministria e Financave ka bashkëpunuar me Ministrinë e Integrimeve Evropiane për të themeluar Këshillin Kombëtar të Investimeve (KKI), i cili është një nga kriteret e BE-së për bashkëfinancim me fondet IPA.

Ministria e Financave ka luajtur rol kyç në përgatitjen dhe konfirmimin e aplikacionit për grant nga BE lidhur me financimin deri në 51% të Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10.

Listat Prioritare e Projekteve janë përpiluar për herë të parë për sektorët e transportit, mjedisit dhe energjisë.

Ministria e Financave, përmes Këshillit Kombëtar të Investimeve ka dërguar në Kornizën e Ballkanit Perëndimor (WBIF) tri aplikacione për studim të fizibilitetit, të cilat janë aprovuar dhe janë ndarë 1.5 milionë euro për të bërë studimin e fizibilitetit për kanalin e Ibër-Lepencit përgjatë lumit Lepenc.

Kursimet në kuadër të Ministrisë së Financave

Duke mos përfshirë agjencitë, në Ministrinë e Financave krahasuar me vitin e kaluar janë bërë këto kursime:

- Në paga/mëditje 9%.
- Në mallra/shërbime 41%.
- Në shërbimet komunale 7%.
- Në subvencione dhe transfere 48%.
- Në udhëtimet zyrtare jashtë vendit 78%.
- Në shpenzime për mëditje nga udhëtimet 20%.
- Në shpenzimet e reprezentacionit 22%.

Prokurimet e centralizuara

Agjencia për Prokurime të Centralizuara, që funksionon brenda Ministrisë së Financave, për herë të parë pas shumë vitesh ka filluar me prokurime të centralizuara bazuar në Udhëzimin Administrativ të miratuar në Qeveri në fillim të vitit.

Janë kryer deri më tani 6 prokurime për derivate, material zyrtar dhe materiale të tjera për mbi 80 organizata buxhetore për furnizim për tri vitet e ardhshme. Kjo do të rezultojë në miliona euro kursime në shpenzime për këto mallra.

Me këtë është plotësuar vërejtja e Komisionin Evropian e paraqitur vazhdimisht në Raportin e Progresit.

Në vitin e ardhshëm, ne do të zgjerojmë numrin e organizatave buxhetore të përfshire me prokurime të centralizuara dhe listën e mallrave që do të prokurohen në mënyrë të centralizuar.

Përgatitja e buxheti për vitin 2016

Buxheti për vitin 2016 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës brenda afatit ligjor. Buxheti është në linjë të plotë me objektivat e Qeverisë për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe stabilitet buxhetor dhe është plotësisht i harmonizuar me Fondin Monetar.

Të hyrat e rregullta buxhetore për vitin 2016 janë planifikuar të jenë 1 miliard e 598 milion euro, që është një rritje prej 4.1% krahasuar me vitin 2015 dhe 19% më shumë se në vitin 2014. Për vitin 2016, shpenzime bazë parashihet të jenë 1 miliard e 678 milion euro.

Në veçanti, në buxhetin e vitit 2016:
• Është rritur për 25% asistenca sociale për 27 mijë familje që janë në këtë skemë.
• Është rritur për 34% buxheti për skemat pensionale të financuara nga shteti për 40 mijë pensionistë kontributdhënës.
• Është ndarë buxhet i mjaftueshëm për kompensimin e përvojës së punës për 80 mijë të punësuar në sektorin publik për gjithë vitin, që është një kosto prej 40 milion euro.
• Vazhdohet mbështetja e bujqësisë,
• Kemi siguruar financim të plotë të pensioneve për veteranët dhe kategoritë e tjera të luftës, në vlerë prej 25 milion.
• Kemi akomoduar plotësisht shpenzimet nëpër organizata buxhetore që derivojnë nga agjenda integruese e Kosovës, që është rreth 6 milion euro.
• Kemi rritur buxhetin për organet e drejtësisë,
o për prokurorinë me 13% dhe
o gjyqësinë me 6%, për ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme.
• Kemi rritur buxhetin për Forcat e Sigurisë së Kosovës me 9%, për modernizim dhe përmbushje të standardeve për transformimin e kësaj force në ushtri.

Buxheti për shpenzime kapitale prej 463 milionë euro mundëson financimin e:
• 39 shkollave dhe anekseve shkollore në mbarë vendin,
• ndërtim të objekteve për universitetet e reja në Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë dhe Pejë,
• 25 objekteve sportive,
• 4 qendra rinore,
• mbi 24 objekte të ndryshme në fushën e shëndetësisë primare, sekondare dhe terciare,
• 15 objekteve të kulturës dhe artit, mbi 116 rrugëve të ndryshme regjionale dhe lokale në tërë Kosovën,
• financimin e mëtejshëm të autostradës Prishtinë-Hani i Elezit dhe të projekteve të tjera kapitale që janë në vijim e siper,
• mbi 30 projekte në ujëra dhe mbrojtje të mjedisit,
• kemi bërë rritje të financimit për pajisje të nevojshme për Forcën e Sigurisë të Kosovës.

Raporti sipas agjencive, departamenteve dhe zyrave

Dogana

Objektivë kryesore e Doganës së Kosovës është sigurimi i të hyrave për buxhetin e shtetit. Raporti për Doganën e Kosovës për vitin 2015, tregon se viti 2015 ka qenë i suksesshëm. Është arritur që deri më 31 dhjetor 2015 të mblidhen saktësisht 951,808,447.18 euro. Gjatë periudhës raportuese 2014 - 2015 për të gjitha regjimet e importit, taksat kanë shënuar ngritje në shumë prej 82,2 ose shprehur në përqindje 9.62%.

Dogana gjatë 2015 ka vënë në përdorim konceptin e paperless. Ka finalizuar projektin e ri të mbështetur nga Ambasada Amerikane në Kosovë për t`iu krijuar kompanive lehtësira në të bërit biznes. Ka përgatitur infrastrukturën për eliminimin e regjistrimit të bizneseve për eksport-import, shitjen e mallrave online, si dhe ka zbatuar projektin E-payment.

Gjatë vitit 2015 është shënuar një ulje e numrit të kërkesave për këshilla ligjore dhe përgjigjeve në to në krahasim me vitin paraprak. Janë proceduar 75 kallëzime penale në Prokurori të shtetit, në vlerë të shmangieve prej 6 milionë euro. Vlera e mallrave të sekuestruara në fazën e hetimeve ka tejkaluar 560.000,00 euro. Gjatë vitit 2015 Dogana ka vazhduar me ritëm të shtuar konfiskimin e mallrave të kontrabanduara dhe substancave narkotike. Është rrit numri i thirrjeve të sakta telefonike në linjën e sigurt të Doganës. Kjo ka ndikuar në rritjen e besimit të qytetarëve në Doganën e Kosovës.

Të dhënat për import tregojnë se në aspektin e peshës për periudhën raportuese 2014 - 2015, pesha neto e importit të mallrave ka shënuar rritje prej 289 milionë kilogram apo shprehur në përqindje 7.6 %. Derisa në vitin 2014, ka pas në total peshë importi prej 3,7 miliardë kilogram këtë vit kemi afër 4 miliardë kilogram produkte të importuara. Vlera e mallrave të importuara ka rritje prej 3.8 % pra nga 2.4 miliardë euro në 2.5 miliardë.

Produktet që janë importuar më së shumti kanë mbetur të njëjta, me përqindje më të madhe janë derivatet e naftës, duhani, automjetet, makineritë e ndryshme, pijet e ndryshme alkoolike dhe jo-alkoolike, plastika etj. Ndërsa vendet nga të cilat importohet më së shumti janë: Serbia, Gjermania, Turqia, Kina, Italia etj.
Ndërsa, sa i përket produkteve të eksportuara gjatë vitit 2015 ka pasur eksport (EX1+EX3) në lartësi prej 390 milionë euro që krahasuar me vitin e kaluar është një rritje e ulët për 6 milionë euro pasi në 2014 kishte eksport me 384 milionë euro. Partnerët kryesor për eksportin e Kosovës janë Shqipëria, Serbia, Maqedonia, India dhe Italia.

Administrata Tatimore e Kosovës

Mbledhja e të hyrave, informimi dhe trajnimet e tatimpagueseve, implementimi i pakos fiskale, trajtimi i njëjtë për të gjithë tatimpaguesit si dhe luftimi i informalitetit, kanë qenë objektivat e Administratës Tatimore të Kosovës, gjatë vitit 2015. Duke pasur parasysh këto objektiva, Administrata Tatimore e Kosovës ka realizuar të hyra në vlerë prej 332.3 mil euro, që në krahasim me vitin 2014 janë realizuar të hyra për 9.4% më shumë ose shprehur në vlerë për 28.6 mil. euro, ndërsa krahasuar me planin prej 340.0 mil. euro për vitin 2015 kemi një ngecje për 2.3% ose për 7.7 mil. euro. Në fushën e harmonizimit dhe zbatimit të legjislacionit tatimor, gjatë vitit 2015 është bërë plotësimi i legjislacionit primar dhe sekondar për ligjet: Nr.03/L-162 për Tatimin në të ardhurat e korporatave, Nr.03/L-161 për Tatimin në të ardhurat personale Nr.03/L-146 për Tatimin mbi vlerën e shtuar.

Po ashtu në fushën e legjislacionit në vitin 2015 ka hyrë në fuqi Ligji për faljen e borxheve publike. Në fushën e informimit të tatimpaguesve, në vitin 2015 janë realizuar gjithsej 423,079 aktivitete që përfshijnë: 4,030 njoftime për tatimpagues, 24 seminare me tatimpagues, materiale informuese, 4,453 përgjigje për tatimpagues dhe shërbime të tjera.

Me qëllim të ngritjes së përmbushjes së obligimeve tatimore, ATK shërbimin elektronik e ka zgjeruar edhe me deklarata të reja ku tani të gjitha deklarimet mund të bëhen në mënyrë elektronike. Vetëm për vitin 2015 janë dorëzuar 1,214,144 deklarime përmes EDI. Përveç kësaj në funksion është edhe shërbimi i vërtetimit tatimor elektronik për persona fizik ku deri më tani janë shtypur 81,101 vërtetime tatimore në mënyrë elektronike dhe raportimi i blerjeve mbi 500€. Në shërbimet elektronike, funksionale është edhe qendra e regjistrimit të bizneseve "One-stop-Shop", ku përmes kësaj qendre deri më tani janë regjistruar gjithsej 33,999 biznese. Qendra e thirrjeve është funksionale nga viti 2011 në ATK dhe e cila ofron shërbime si njoftime, përgjigje në pyetjet për obligime tatimore nga tatimpaguesit, etj. Rezultatet në të hyra nga kjo Qendër janë mbi 1.25 milionë euro.
Në fushën e luftimit të evazionit fiskal janë realizuar aktivitete të përbashkëta me institucionet përgjegjëse me qëllim të parandalimit të evazionit fiskal, ku gjatë vitit 2015 janë realizuar 20 aktivitete të përbashkëta me institucionet e zbatimit të ligjit si me Policinë, Inspektoratin e Policisë së Kosovës dhe Doganën. Në këtë drejtim gjatë vitit 2015 janë trajtuar 49 raste për vepër penale të shmangies tatimore.
Në realizimin e Planit vjetor të Trajtimit të Rreziqeve 2015, janë kryer gjithsej 55,039 vizita, rezultatet e të cilave kanë qenë: 3,892 punëtorë të regjistruar; 1.1 milionë euro mall pa origjinë; 181.5 mil. euro qarkullim shtesë; 6.6 mil euro ulje të kreditimit dhe 10.3 milionë euro zvogëlim të humbjes. Ndërsa numri i kontrolleve të realizuara ishte 1,282 kontrolle, me rezultate tatim shtesë 42.6 milionë euro, 8.5 milionë euro kreditim të zbritur dhe 48.8 milionë euro zvogëlim të humbjes.

Departamenti i Buxhetit

Gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2015, Departamenti i Buxhetit ka zhvilluar aktivitetet si vijon: Pas aprovimit të Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 Departamenti i Buxhetit ka vendosur në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK) buxhetin e aprovuar për vitin 2015 për ekzekutim.
Gjithashtu ka nxjerrë instruksionin nr. 39 më 12.01.2014 për zbatimin e nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015. Në bazë të Ligjit të përmendur dhe instruksionit të lëshuar për Organizata Buxhetore, janë përfshirë të gjitha ndryshimet për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare të projekteve kapitale shumëvjeçare ndaj kontraktuesve ekonomik nga viti 2014 në vitin 2015. Këto ndryshime në projekte kapitale janë aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 06/12, me 05.02.2015.

Procesit për hartimin e Projektligjit për Buxhetin e vitit 2016 dhe vlerësimeve për vitet 2017-2018 nga Departamenti i Buxhetit i kanë paraprirë dokumentet dhe aktivitetet si vijon:

Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018
Është nxjerr instruksioni Nr. 661, datë 03.04.2015 për Përgatitje të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASh) 2016-2018. Dokumenti i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018 është përgatitur dhe është aprovuar me Vendimin Nr. 09/25, të datës 29.04.2015 dhe të njëjtin e ka proceduar në Kuvend për informim.

Hartimi i Qarkoreve buxhetore 2016-2018
Duke u bazuar në dokumentin e KASH-it, është nxjerr Qarkore buxhetore 2016/01 me 15.05.2015. Ky dokument në vete përmban Udhëzimet për përgatitjen e Buxhetit, kufijtë fillestar 2016-2018 (përjashtuar kufijtë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve) dhe kalendarin buxhetor për përgatitjen e Propozim Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016-2018.

Është lëshuar Qarkorja Buxhetore 2016/02 nr.1453 të datës 04.08.2015 e cila përmban kufijtë e shpenzimeve për çdo organizatë buxhetore për vitin 2016 të shpërndarë nëpër kategori ekonomike si dhe kufijtë e vlerësimeve për vitet 2017-2018.

Nga data 31 gusht - 04 shtator janë mbajtur dëgjimet buxhetore me të gjitha organizatat buxhetore nga të cilat dolën konkluzione përkatëse.

Është nxjerr qarkorja buxhetore 2016/03 dhe me shkresën nr.1918 të datës 06.10.2015 iu është dorëzuar të gjitha organizatave buxhetore. Përmes kësaj qarkoreje është ofruar përmbyllja e propozim buxhetit për vitin 2016 nga ana e Ministrisë së Financave, me ç 'rast janë dhënë kufijtë final buxhetor në total dhe sipas kategorive ekonomike për të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror.

Rishikimi i Buxhetit për vitin 2015
Më 22 maj 2015 është nxjerr dhe shpërndarë OB Instruksioni Nr. 1011 për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2015. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 është përgatitur nga Departamenti i Buxhetit dhe i njëjti është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 16.07.2015.

Projektligji i Buxhetit të Republikës së Kosovës për periudhën afatmesme 2016-2018
Departamenti i Buxhetit pas nxjerrjes së Qarkores së tretë ka përgatitur Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për periudhën afatmesme 2016-2018 duke përkrah kërkesat e organizatave buxhetore sipas prioriteteve dhe politikave të Qeverisë brenda kornizave buxhetore në pajtim me rregullën fiskale e cila përcakton kufirin e nivelit të deficitit buxhetor në raport me BPV si dhe në pajtim me marrëveshjen me FMN-në.

Ky Projektligj është dorëzuar në Qeveri për aprovim në afatin e paraparë ligjor. Është aprovuar dhe i njëjti është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Janë mbajtur takimet e rregullta me Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës të Kosovës si dhe janë përgatitur amendamentet për Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 14 dhjetor 2015 ka aprovuar Ligji Nr. /L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe i njëjti është dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës me datë 29 dhjetor 2015.

Aktivitete të tjera të Departamentit të Buxhetit
Në bazë Planit të punës së Qeverisë dhe Ligjit të Buxhetit vjetor për të gjitha kërkesat për dhënie të opinionit të pavarur të Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor të pranuara nga institucionet propozuese të legjislacionit të ri apo plotësim ndryshim të atij aktual si dhe strategjive, Departamenti i Buxhetit i ka përgatitur dhe dorëzuar propozuesve. Gjithsej janë dhënë 171 opinione të pavarura dhe atë si vijon për: 96 - projektligje; 26 - projekt-rregullore; 14- projekt-udhëzime administrative; 20 – strategji dhe plane të veprimit; 14 – koncept-dokumente dhe 1 – program.

Aktivitetet tjera të DB-së janë edhe nxjerrja e Udhëzimit Administrativ 03/2015 për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare, pjesëmarrje në takimet me Fondin Monetar

Ndërkombëtar lidhur me procesin buxhetor dhe Rregullën Fiskale, Pjesëmarrje në grupe punuese në bazë të Vendimeve të Zyrës së Kryeministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, pjesëmarrja në grupe punuese (me kërkesë të OB-ve) në organizata buxhetore lidhur me përgatitjen e projekt-ligjeve, pjesëmarrje në grupe punuese për hartimin e dokumentit të KASh-it 2016-2018 si dhe hartimin e buxhetit për vitin 2016. Gjithashtu DB në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit ka bërë konsultimet paraprake për të gjitha propozim vendimet e Qeverisë të cilat kishin implikime buxhetore. Janë përgatitur materialet për mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ministrin dhe sekretarin e MF-së.

I rëndësishëm për DB ka qenë edhe administrimi i sistemeve PIP dhe BDMS ku është bërë edhe dhënia e qasjes individuale, ruajtja e të dhënave të përditshme, përkrahja e analistëve të buxhetit komunal dhe qendror sipas nevojës, përkrahje për zyrtarët e TI-së së institucioneve në instalimin e sistemit, nxjerrja e të dhënave nga data baza sipas kërkesave, hapja e kodeve të reja buxhetore sipas kërkesës së menaxhmentit, arkivimi i të dhënave sipas kërkesës së menaxhmentit, ndalja dhe aktivizimi i sistemit sipas kërkesës së Departamentit të Buxhetit Qendror dhe Komunal, rregullimi i skriptës për importimin e kapitaleve nga sistemi i PIP-it në BDMS, krijimi i skriptave për azhurnimin e përdoruesve të nivelit komunal, etj.
DB ka bërë edhe raportimet e rregullta tremujore dhe vjetore për realizimin e detyrave si,
Raportimi i monitorimit të projekteve kapitale për vitin 2014.

Departamenti i Buxhetit Komunal

Ndarja e Granteve qeveritare për komunat

Departamenti i Buxhetit Komunal në Ministrinë e Financave ka zbatuar kornizën ligjore të financimit për periudhën janar-dhjetor 2015 në pajtim me parimet, kriteret dhe formulat bazë të përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave, Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale si dhe prioritetet strategjike qeveritare në KASH gjatë procesit buxhetor.

Me datë 22 janar 2015 është mbajtur takimi për përzgjedhjen me short të katër anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve nga niveli komunal me mandat ligjor njëvjeçar për vitin 2015. Anëtarë të rinj të Komisionit të Granteve u zgjodhën përfaqësuesit e komunave: Mitrovicë, Shtime, Kamenicë dhe Partesh.

Komisioni i Granteve, ka aprovuar kufijtë e financimit të Komunave nga grantet qeveritare dhe projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2016 me parashikimet për vitin 2017-2018, si pjesë integrale e KASH-it 2016-2018.

Sipas kalendarit buxhetor, MF ka lëshuar Qarkoret Buxhetore 2016/01, 02 dhe 03 me kufijtë e financimit dhe strukturën e shpenzimeve për komuna për vitin 2016, po ashtu komunat kanë dorëzuar në MF Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitin 2016-2018.

Po ashtu sipas kalendarit buxhetor deri më datë 30 shtator 2015, kuvendet komunale kanë aprovuar buxhetin 2016-2018 duke respektuar kufijtë e financimit të përcaktuar në Qarkoren Buxhetore 2016/01 dhe kufijtë e shpenzimeve të përcaktuar në Qarkore Buxhetore 2016/02 dhe 03, ndërsa katër komunat veriore dhe komunat Gllogoc, Junik dhe Kllokot nuk e kanë respektuar strukturën buxhetore sipas qarkoreve buxhetore dhe bazuar në nenin 62 të LMFPP për këto komuna Qeveria në projektligjin e Buxhetit për vitin 2016 me datë 30 tetor 2015 ka aprovuar buxhetin historik të vitit fiskal paraprak 2015.

Me datë 17 dhjetor 2015 Komisioni i Granteve, bëri përzgjedhjen me short të anëtarëve të rinj për vitin 2016 (katër kryetarë të komunave: Prizren, Dragash, Klinë dhe Graçanicë).

Menaxhimi efikas, transparent dhe i drejtë i financave publike, ekzekutimi dhe raportimi i rregullt përmes sistemeve PIP dhe BDMS.

Në SIMFK janë ekzekutuar të gjitha vendimet e Qeverisë për ndarjen e mjeteve shtesë për disa komuna. Janë ekzekutuar në SIMFK Vendimet e Qeverisë për shpërndarjen e fondit të kontingjencës në paga për pagesën e përvojës së punës për komunat. Janë shfrytëzuar sistemet PIP dhe BDMS për planifikim dhe ekzekutim të buxhetit komunal për vitin 2015 si dhe po ashtu për vitin 2016-2018.

Bordi Menaxhues i Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit ka aprovuar projektet kapitale për komunat Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë veriore si dhe janë ekzekutuar në SIMFK duke u bazuar në Ligjin e Buxhetit për vitin 2015 neni 9 paragrafi 3, 4 dhe 5 si dhe neni 14 paragrafi 7.

Autoriteti Qendror i Prokurimit

Agjencia Qendrore e Prokurimit për herë të parë gjatë vitit 2015 ka kryer aktivitete të prokurimeve të centralizuara. Vlera totale e kontratave të nënshkruara nga zyrtarët përgjegjës të AQP-së me operatorët ekonomik është: 3,611,316.58 euro. Sipas raportit, Prokurimet e Veçanta brenda AQP-së gjatë vitit 2015 janë kryer me sukses ku sipas kërkesave të Autoriteteve Kontraktuese që kanë dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit konform nenit 95 pika 4 e LPP nr. 04/L-042 janë zhvilluar me sukses gjashtë aktivitete të prokurimit për vitin fiskal 2015.

Njësia e Inteligjencës Financiare

Objektivat e Njësisë së Inteligjencës Financiare për vitin 2016 kanë qenë, kompletimi i kornizës ligjore për luftën kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, forcimi i parandalimit si dhe luftës kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, promovimi i procedurave të inteligjencës, zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe ngritja e kapaciteteve të NJIF-it në luftimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit. Për kompletimin e kornizës ligjore për luftën kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit kanë kontribuuar edhe miratimi i Koncept Dokumentit për ndryshim plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit nga Qeveria me 05 shkurt 2015.
Sa i përket legjislacionit sekondarë, gjatë vitit 2015, janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi dy Urdhëresa Administrative siç janë, Urdhëresa administrative NJIF-K nr. 02/2015 për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave si dhe Urdhëresa administrative NJIF-K nr. 03/2015 për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit.

Njësia për Inteligjencë Financiare gjatë vitit 2015 ka realizuar gjithsej 26 inspektime të pajtueshmërisë. Gjithashtu, NJIF ka miratuar dokumentin strategjikë të NJIF "Plani i Performancës dhe Resurseve të Njësisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017", i cili pritet të implementohet në tri vitet e ardhshme. Kështu që Kosova duhet të bëjë ndryshimet ligjore sa i përket financimit të terrorizmit, me qëllim që pjesa ligjore të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe të vazhdoj rrugën e anëtarësimit në Egmont. Në vitin 2015, NJIF-K ka nënshkruar dy Memorandume të Mirëkuptimit me FIU Hungari dhe FIU Ghana, përderisa është ri nënshkruar marrëveshja e re e bashkëpunimit me FIU Maqedonia. Në periudhën e parë të vitit 2015 NJI-K ka krijuar qasjen direkte në Data bazën e Regjistrimit Civil dhe Regjistrimit të Automjeteve. Kjo është arritur përmes nënshkrimit të MM në mes ARC dhe NJIF-K. Po ashtu NJIF-K dhe Dogana e Kosovës kanë bërë harmonizimin e Statistikave për periudhat e kaluara vjetore.

Thesari

Objektivat e Thesarit për vitin 2015 kanë qenë: Zhvillimi i tregut të letrave me vlerë, dhe Menaxhimi efikas dhe efektiv i borxhit të përgjithshëm shtetëror.

Zhvillimi i tregut të letrave me vlerë është bërë në pajtim me Kalendarin e Emetimeve të Letrave me Vlerë 2015, ku gjatë vitit 2015 janë mbajtur 21 ankande. Nga to 7 ankande u mbajtën për tu emetuar instrumente të reja, ndërsa ankandet e tjera ishin për të ri-financuar maturimet. Gjithashtu, përveç vazhdimit të emetimit të instrumenteve 3, 6, 12 muaj dhe 2 vjeçare, janë emetuar me sukses për herë të parë obligacione me maturitet 3 dhe 5 vjeçar.

Sa i përket Rishikimit të Rregullores së Letrave me Vlerë dhe komunikimit, Divizioni për Menaxhimin e Borxheve (DMB) ka mbajtur takimet tre-mujore me Akterët dhe Pjesëmarrësit e tregut dhe ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për akomodimin e kërkesave të tyre për një treg transparent dhe të rregullt. Gjatë vitit 2015 në vazhdimësi janë monitoruar të gjithë treguesit e rrezikut relevant për menaxhimin e Borxhit Shtetëror dhe është konstatuar se të gjithë treguesit e rrezikut kanë qenë brenda niveleve të përcaktuara në Strategjinë e Borxhit.

Gjithashtu servisimi i borxhit është bërë konform marrëveshjeve financiare. Po ashtu në pajtim me marrëveshjet financiare në fuqi dhe bazës ligjore, janë shlyer me kohë të gjitha obligimet ndaj kreditorëve të Republikës së Kosovës si dhe është bërë negocimi me kreditorë për marrëveshje të reja financiare.

Gjatë vitit 2015 është negociuar programi i ri me FMN, i cili parasheh kredi për mbështetje buxhetore rreth 185 milionë euro. Gjithashtu, janë negociuar dhe janë nënshkruar 8 marrëveshje ndërkombëtare me IFN, me një shumë totale prej rreth 175 milionë euro, për të financuar projekte kryesisht në fushën e infrastrukturës së transportit, efiçiencës së energjisë dhe shëndetësisë. Gjithashtu, është negociuar marrëveshja për garanci shtetërore për projektin e trafikut urban. Përgatitja e manualeve për barazimin bankar, përgatitjes së ekstraktit për pagesë nga LLVTH te llogaritë e përfitueseve.

Në bazë të planit janë organizuar dhe mbajtur trajnimet për 1,590 përdorues të SIMFK-së me Organizatat Buxhetore. Është bërë edhe monitorimi i vazhdueshëm i versionit 7.0 dhe është bërë përkrahja e OB-ve përmes TN për përdorim të sistemit V7 po ashtu është bërë hapja e tiketave për raportime në SIMFK 2015, konfigurimi i serverëve - Instalimi i përditësimeve dhe testimi për ngritjen e performancës në serverët e ri, avancimi i sistemeve për përdoruesit e brendshëm të Thesarit. Kalimi në e-mail qeveritar rks-gov dhe përfundimi i avancimit të sistemit operativ në Win8.1 për stafin e Thesarit si dhe Transferimi dhe funksionalizimi i pajisjeve për ruajtjen e Backup (shënimeve) nga ambientet e BQK-së në ASHI(MAP). Gjatë vitit 2015 MF/Thesari ka përgatit raportet mujore të ekzekutimit të buxhetit, raportet tremujore të cilat raporte janë miratuar në Qeveri dhe dërguar në Kuvend konform kërkesave të LMFPP-së. Në muajin mars 2015 është aprovuar në Qeveri dhe dërguar në Kuvend Raporti Vjetor për vitin 2014 konform kërkesave të LMFPP, është përgatit dhe dërguar tek FMN raporti mujor sipas kërkesave të marrëveshjes Qeveri-FMN dhe formatit të kërkuar me TMU si dhe është raportuar në vjetarin e Statistikave Financiare Qeveritare në FMN për herë të parë për vitin 2012-2014 në formatin që kërkohet nga GFSM.

Departamenti Qendror Harmonizues

Departamenti Qendror Harmonizues ka përgatitur strategjinë e KBFP-së 2015-2019 dhe gjithë dokumentacioni përcjellës për aprovimin e saj nga Qeveria e Kosovës. Strategjia për KBFP 2015-2019 nga Qeveria është aprovuar më 15.04.2015. Për implementimin e strategjisë Departamenti Qendror Harmonizues ka hartuar edhe planin e veprimit ku janë përcaktuar veprimet që duhet të merren për implementimin e tij, përgjegjësit, koha dhe kostot.
NjQH ka organizuar konferencën për KBFP për nivelin e lartë qeverisës e cila ishte e planifikuar edhe me planin e veprimit të strategjisë për KBFP 2015-2019. NJQH ka përgatitë draft koncept dokumentin për Ligjin e MFPP-së, një draft propozim për plotësim/ndryshim të Ligjit të MFPP, një draft për plotësim/ndryshim të Ligjit për Auditim të Brendshëm dhe draftin e ri të ligjit për Auditim të Brendshëm.

Departamentit i Auditimit të Brendshëm

Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka kryer auditime në Ministrinë e Financave sipas planit të punës dhe kërkesave të ministrit ka bërë auditimin e departamenteve që janë në kuadër të Ministrisë së Financave. Gjatë vitit 2015 është bërë auditimi edhe i menaxhimit të kontratës për fabrikën e ujit Vushtrri. Auditim i veçantë i është bërë implementimit të rekomandimeve të vitit 2015.
Departamenti i Auditimit të Brendshëm ka kryer auditime edhe tek Autoriteti Kosovar i Hekurudhave, Instituti Gjyqësor i Kosovës, në Agjencinë Kosovare Kundër Konkurrencës, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Këshillin Kosovar për Trashëgimi Kulturore, Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit si dhe në Ministrinë e Diasporës.
Për këto auditime janë dhënë 50 rekomandime të cilat janë pranuar në tërësi, dhe adresuar për implementim. Ndërsa nga auditimet e bëra në këto institucione, sfidë ka dalë vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara.

Departamenti Qendror për Partneritete Publiko Private

Departamenti Qendror për Partneritete Publiko Private ka përgatitur dhe mbajtur gjithsejtë 9 takime të Komitetit për Partneritete Publiko Private me përbërje të re, ku janë shqyrtuar 4 projekte, janë marrë 4 vendime për aprovimin e projekteve PPP është marrë një vendim për kontratë përfundimtare PPP, janë trajtuar 2 projekte nga fusha e minierave dhe mineraleve si dhe është themeluar njësia për monitorimin e Kontratës PPP në ANP.

DQPPP ka ofruar vazhdimisht asistencë teknike komunave në vijim: Prizren tri projekte, Gjilan dy projekte të reja, një projekt në fazën e negocimit dhe aprovimit final të projektit, Pejë dy projekte të reja dhe koncept ide për disa projekte të reja, Prishtinë dy projekte, Mitrovicë tri projekte, Gjakovë dy projekte, Podujevë një projekt dhe Ferizaj një projekt si dhe DQPPP ka prezantuar në Konferencën e Investitorëve në Komunën e Gjakovës. Në kuadër të konsultave janë mbajtur takime në lidhje me PPP-të për koncept-projektet e autoriteteve publike.

DQPPP është anëtare e grupit punues për PPP që nga viti 2013 dhe në mënyrë aktive ka ofruar përvojën e vet për njësitë PPP të rajonit, dhe si rezultat DQPPP në bazë të studimit krahasues të rajonit është cilësuar si një nga njësitë më të avancuara në rajon. Gjithashtu, DQPPP ka marrë pjesë në seminarin e përbashkët të ReSPA dhe BERZH në lidhje me Partneritetet Publiko Private, Londër, Mbretëri e Bashkuar. DQPPP ka ofruar asistencë në komisionin ndërministror për projektin "Kosova e re" dhe Brezovica. Asistenca është ofruar për Ministrinë e Financave në cilësi të anëtarit të Komitetit Drejtues Ndër-Ministror të këtyre projekteve. Gjithashtu, DQPPP ka marrë pjesë në komisione vlerësuese në lidhje me projektin "Kosova e re".

Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Departamentit për Politika Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar ka qenë bashkëpjesëmarrës në amendamentin e Ligjit të TVSH-së, Ligjit të Tatimit të Mbajtur në Burim, Ligjit të Tatimit në Korporata, në ndryshimin e Udhëzimit administrativ mbi Pajisjet Elektronike dhe Sistemet Fiskale, në grupet punuese për rishikimin e Marrëveshjeve Financiare për Ristrukturimin e Kredisë së KEK-ut, në përgatitjen e analizave mujore mbi performancën e të hyrave dhe shpenzimeve përgjatë vitit 2015, si dhe në përgatitjen e Raportit Vjetor (2014) për Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Luftimit të Ekonomisë Joformale dhe Krimeve Financiare.
Në Këshillin Ekonomik Social, ka përgatitur Analizat e efektit të uljes së pragut të TVSH-së, Analizat e efektit të lirimit të linjës së prodhimit nga ngarkesa doganore, analizat e ndryshimeve tatimore (akciza në duhan, pije alkoolike, etj.)
Është bërë plotësimi i pyetësorit të FMN dhe i njëjti i është dërguar këtij institucioni. Departamenti ka qenë i angazhuar në negociatat me FMN mbi hartimin e klauzolës për investime si dhe rregullës për pagat në sektorin publik.

Departamenti ka bërë edhe përgatitjen e kornizës makro-fiskale për KASH 2016-2018. Ka hartuar raportin për DPSA "Ekonomi, Kontroll Financiar dhe Statistika". Ka përgatit raportin për ndikimin fiskal të MSA-së. Ka përgatitur Raportin dhe plotësimin e matricave për Raport të Progresit si dhe ka marrë pjesë në Komitetin Drejtues të projektit të BE-së me ASK për ngritjen e kualitetit dhe qasjes në statistika. Po ashtu ka hartuar raportin për kapitullin mbi qëndrueshmërinë makroekonomike për Planin Kombëtar për Adaptim të Acquis si dhe politikat fiskale. Ka hartuar buletinin ekonomik gjashtëmujorë për periudhën janar-qershor 2015. Ka bërë përgatitjen e udhëzimit administrativ mbi listën e lirimeve të produkteve të caktuara nga tatimi doganor, si dhe ka përgatitur analiza dhe dokumente përcjellëse për vendosjen e akcizës në disa produkte të energjisë.

Gjithashtu gjatë vitit 2015 janë mbajtur takime të rregullta me institucionet financiare ndërkombëtare, përfaqësuesit e Programit G2G, Ambasadën Zvicerane, Gjermane, Luksemburgut etj.

Janë zhvilluar negociata për Marrëveshjen Ndërkombëtare për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë me Emiratet e Bashkuara. Është bërë përgatitja e dokumentacionit për procedimin e kërkesës së EIB rreth kredisë së ProCredit Bank. Janë konkretizuar me nënshkrimin e marrëveshjes negociatat me BERZH për marrjen e kredisë për rehabilitimin e Hekurudhave ku palët janë pajtuar me marrëveshjen e kredisë. Gjatë muajit korrik me kërkesën e Ministrisë së Financave, Qeveria e Kosovës ka aprovuar nismën për të negociuar kredinë me Bankën Botërore për Projektin e Përmirësimit të Sistemit të Arsimit. Është mbajtur takimi i brendshëm i ekipit për negocim të marrëveshjes kornizë me Qeverinë Gjermane ku është vendosur për formën e negociatave me palën gjermane dhe ratifikimin e kësaj marrëveshje përmes Kuvendit.

Është përgatitur dhe nënshkruar marrëveshja për nën huazim për Ujësjellësin rajonal të komunës së Gjakovës. Kjo marrëveshje vjen si pjesë e marrëveshjes bazë të nënshkruar në mes të KfW-së dhe Ministrisë së Financave në vitin 2014 në vlerë prej 13,600,000 euro grant.

Gjatë vitit 2015 nga departamenti janë pranuar letrat konfirmuese nga ana e Qeverisë së Zvicrës dhe Austrisë për fillim të negociatave për METD. Negocimin e marrëveshjes me Qeverinë e Konfederatës Zvicerane të përfaqësuar nga Departamenti Federal i Çështjeve Ekonomike, Arsimit dhe Hulumtimit, për marrëveshjen "Largimi i Ujërave të Zeza në Jug-Perëndim të Kosovës, faza IV", në Komunën e Pejës.

Departamenti i Tatimit në Pronë

Departamenti i Tatimit në Pronë është i përqendruar në zbatim të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë, ku në bazë të këtij ligji është bërë inspektimi vjetor i 34 komunave të cilat e kanë zbatuar tatimin në pronë dhe mbledhin të hyra nga ky tatim. Është bërë vendosja në sistem e vlerave të pronave, normave tatimore dhe zonave tatimore.

DTP ka bërë edhe llogaritjen e përgjithshme të faturave të tatimit në pronë për 34 komunat. Është bërë shtypja dhe shpërndarja e faturave tatimore për vitin 2015, për të gjitha komunat. Janë shpërndarë 474.972 fatura, të cilat kapin shumën prej 22.234.111 Euro. Është funksionalizuar programi QGIS që përmban të dhënat kadastrale grafike dhe tekstuale si dhe kontratat e shit-blerjeve. Janë trajnuar vlerësuesit dhe ekipet e kontrollës për përdorim të programit QGIS me qëllim të ndryshimit të shfrytëzimit aktual dhe vizatimit të zonave të vlerësimit si dhe parcelave bazuar në fotografimin ajror të vitit 2012.

Është përgatitur broshura informuese për tatimpagues dhe janë shpërndarë së bashku me faturat e tatimit të vitit 2015. Është hartuar draft Udhëzimi Administrativ për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet, dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin. Nga zyrtarët përgjegjës janë shqyrtuar me kohë të gjitha kërkesat si nga niveli qendror ashtu edhe nga niveli komunal për vlerësimin e pronave të paluajtshme.

Në koordinim me projektin e USAID, Avancojmë Kosovën së Bashku, dhe projektin e SDC, Decentralizim dhe Përkrahje Komunave, me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) Departamenti për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal (DBZHR) më 18 dhe 19 mars të vitit 2015 është mbajtur punëtoria për Të Hyrat Vetanake Komunale.

Është përgatitur ambienti për programin e ri të tatimit në pronë ProTax2 në të cilin është zhvilluar faqja e cila ka të bëjë me të dhënat e pronës, tatimpaguesit dhe relacionit si dhe është bërë migrimi i informatave të pronave dhe tatimpaguesve nga ProTax1 në ProTax2 me përjashtim të pronave apo tatimpaguesve që kanë problem, të dhëna këto që u janë dërguar komunave për përmirësim. Është përgatitur Koncept Dokumenti për Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-204 "Për tatimin në pronën e paluajtshme" i cili është aprovuar në Qeveri me dt. 12.08.2015. Është zhvilluar sistemi i E-Shërbimi-it për shtypjen e "faturës së tatimit në pronë" Online (përmes internetit/ueb faqes) nga tatimpaguesit. DTP duke u bazuar në planin dhe agjendën dhe në përputhje me marrëveshjen për implementimin e projektit ka mbajtur takimet e komitetit drejtues në lidhje me projektin ProTax2.

Është përgatitur Memorandumi shpjegues, Deklarata e përputhshmërisë me direktivat e BE-së si dhe vlerësimi i ndikimit financiar lidhur me udhëzimin administrativ për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin, është punuar në hartimin dhe draftimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme për përfshirje ligjore edhe të tatimit në tokë. Nga DTP janë shqyrtuar draft rregulloret komunale për vitin tatimor 2016 për të gjitha komunat të cilat i kanë sjell në DTP bazuar në kërkesat e drejtuara për këtë qëllim.

Në programin e tatimit në pronë (sistemin) janë bërë përgatitjet për implementimin e automatizuar të ligjit për faljen e borxheve publike konkretisht për borxhet e tatimit në pronë. Janë zhvilluar aktivitete dhe trajnime nëpër komuna bazuar në kërkesat e tyre për faljen e borxheve (ndryshimet në sistem) dhe informimin e zyrtarëve komunal dhe tatimpaguesve. Gjatë vitit 2015 për tatimin në pronë nga 34 komunat janë inkasuar 18.762.093 Euro.

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme

Gjatë periudhës raportuese DBF, pas përfundimit të vitit fiskal 2014, si veprim të parë ka bërë barazimin e të hyrave dhe të shpenzimeve me Thesarin. Në janar janë përgatitur Pasqyrat Financiare për vitin fiskal 2014 si dhe regjistrimi i rregullt i pasurisë së re me vlera financiare, përfshirë të gjitha të dhënat tjera që kërkohen në programin qeveritar e-Pasuria dhe në aplikacionin intern të MF-së. Lidhur me zbatimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, Ministria e Financave ka përgatitur kërkesën lidhur me obligimet e vitit paraprak.
MF sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës ka përgatitur raportin e detajuar për progresin e arritur në zbatimin e të gjitha projekteve kapitale / PIP si dhe raportin e progresit fizik për projektet kapitale.
Është bërë përcjellja e bilancit të shpenzimeve, Faturimi i rregullt për mbajtjen dhe evidencën e të hyrave, regjistrimi i pasurisë si dhe është bërë barazimi i të hyrave me departamentin e Thesarit. Janë përgatitur Pasqyrat Financiare për vitin fiskal 2014, të përgatitura sipas Rregullës Financiare MF nr. 03/2013.
Gjatë periudhës raportuese janë adresuar gjithashtu kërkesat e dala nga, KASH-i 2016-2018, Instruksioni për Rishikimin e buxhetit për vitin 2015, Qarkorja Buxhetore 2016/01, Qarkorja Buxhetore 2016/02, Qarkorja Buxhetore 2016/03, Raporti i Performancës për vitin fiskal 2014, Pasqyrat financiare për periudhën janar – shtator 2015, Vendimi i Qeverisë nr.09/65 si dhe Kërkesa e Thesarit lidhur me kursimet e mjeteve të zotuara.

Departamenti Ligjor

Gjatë kësaj periudhe, fushëveprimi i Departamentit Ligjor ka qenë i fokusuar kryesisht në objektivat e përcaktuara për vitin 2015, në Koordinimin dhe hartimin e akteve normative në fushëveprimin e MF-së, në ofrimin e asistencës juridike për negocimin dhe efektivitetin e marrëveshjeve ndërkombëtare, në dhënien e opinioneve dhe interpretimeve juridike për institucionet publike dhe palët private. Gjithashtu aktiviteti kryesor i Departamentit Ligjor është realizuar në kuadër të koordinimit të procesit të hartimit të akteve normative dhe dokumenteve strategjike për legjislacion.
Brenda periudhës raportuese, DL ka koordinuar procesin e hartimit të projektligjeve, të cilat brenda periudhës raportuese janë ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës të cilat janë:

o Ligji nr. 05/l -001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015,
o Ligji nr. 05/l -011 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për Efiçiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtërishme,
o Ligji nr. 05/l -012 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Projektin për Reformën Shëndetësore,
o Ligji nr. 05/l -013 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të Përmirësuar Pajtueshmërinë e Rregulloreve Tatimore në Nivel Ndërkombëtar dhe Zbatimin e Rregulloreve FATCA,
o Ligji nr. 05/l -046 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 05/l-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës,
o Ligji nr. 05/l -028 për Tatimin në të Ardhurat Personale,
o Ligji nr. 05/l -037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.
o Ligji nr. 05/l-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave,
o Ligji nr. 05/l -043 për Faljen e Borxheve Publike,
o Ligji nr. 05/l -045 për Sigurimet,
o Ligji nr. 05/l -071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, si dhe
o Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194 dhe me ligjin nr. 05/L -063.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës këto projektligje:
o Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe BERZH për Projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10,
o Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Ndërsa, projektligjet të cilat janë në proces dhe janë bartur në strategjinë legjislative për vitin 2016 janë këto:
o Projektligji për Ndihmën Shtetërore,
o Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Auditim dhe Raportim Financiar,
o Projektligji për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave,
o Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
o Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 01/101 për Fondet Pensionale të Kosovës,
o Projektligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Projektligji për Agjencinë e të Hyrave, si dhe
o Projektligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Brenda periudhës raportuese për vitin 2015, DL ka koordinuar procesin e hartimit të këtyre akteve nënligjore, të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave:

o Udhëzimi Administrativ MF-nr. 01/2015 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike dhe Sistemeve Fiskale,
o Udhëzim Administrativ MF – nr. 02/2015 për Miratimin e Metodave dhe Kritereve Teknike të Vlerësimit për Përllogaritjen e Shumës së Kompensimit për Pronën e Paluajtshme që Shpronësohet, dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin,
o Udhëzimi Administrativ MF-nr. 03 / 2015 për Zbatimin e Ligjit nr.05/l-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar,
o Udhëzim Administrativ MF-nr. 04/2015 për Strukturën dhe Përmbajtjen e Pasqyrave Financiare Vjetore për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme,
o Rregullore MF - nr. 01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Rekrutimit, Zhvillimit, Transferimit dhe Shkarkimit të Stafit,
o Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 03/2015 për Vlerësim të Ndikimit Buxhetor për Nismat e Reja Qeveritare, Udhëzim Administrativ (QRK) - nr. 04/2015 për Procedurat e Faljes së Borxheve Publike, si dhe
o Udhëzim Administrativ QRK - nr. 05/2015 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor.

Departamenti Ligjor gjatë periudhës raportuese njëvjeçare ka marrë pjesë në grupet punuese për negocimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të karakterit financiar, ku është përkujdesur që marrëveshjet e nënshkruara të jenë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe, Presidentja e Republikës së Kosovës ka dekretuar këto marrëveshje:
o Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës Veriore për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal lidhur me tatimet mbi të Ardhurat dhe mbi kapitalin,
o Marrëveshja ndërmjet KFW Frankfurt am Main ("KfW") dhe Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave ("përfitues") dhe Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi në Gjakovë (KRUR) ("Agjencia Ekzekutive e Projektit") deri në euro 13,600,000.-- Mënjanimi i Ujërave të Zeza në Jugperëndim të Kosovës, faza e III,
o Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2014 ("Projekti i Subvencioneve), si dhe
o Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2015 ("Projekti i Subvencioneve).

Gjatë kësaj periudhe janë nënshkruar marrëveshjet:
o Marrëveshja për Grant ndërmjet Sekretariatit të Shtetit për Punë të Jashtme dhe të Komonwethit të Britanisë së Madhe dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës për mbështetjen e "Projektit të zgjidhjes së ankesave lidhur me pronën e paluajtshme, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale" të Agjencisë Kosovare të Pronës, si dhe
o Marrëveshja për Grant ndërmjet Republikës së Kosovës (e përfaqësuar nga Ministria e Financave) dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar për realizimin e Projektit të dytë të Zhvillimit të Rinisë –Financimi Shtesë dhe Fondi i Ndërtimit të Paqes.
Departamenti Ligjor ka dhënë edhe opinione dhe interpretime juridike për institucionet publike dhe palët private. Në kuadër të fushëveprimit Departamenti Ligjor ka kryer edhe detyra specifike, të cilat burojnë nga legjislacioni, të përcaktuara nga eprorët dhe të realizuara me vetë iniciativën e Departamentit Ligjor.

Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave

Ministria e Financave gjatë 2015 ka ndërmarr aktivitete në adresimin e standardeve dhe parimeve të BE-së në fushat e ndryshme përfshirë Strategjinë e KBFP, hartimin e Strategjisë për MFP, në përgatitjet për Përkrahjen Buxhetore Sektoriale (SBS), përgatitjen e Programit Kombëtar të Reformave Ekonomike (PKRE) 2016, zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017, freskimin e Profilit të Migrimit dhe Planit të tij të veprimit për vitin 2015, hartimin e KASH 2016-2018 të MF-së, identifikimin e obligimeve të MF nga Raporti i Vendit (ish Raporti i Progresit) të Komisionit Evropian si dhe adresimin e tyre në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA).
Gjatë periudhës raportuese kemi bërë monitorimin dhe raportimin periodik mujor të zbatimit të Planit Vjetor për Zbatimin e Sfidave të dala në Raportin e Progresit (PVRP) dhe obligimeve nga fusha e Liberalizimit të Vizave, është bërë raportimi i zbatimit PVRP 2015 për Kosovën, për kuartalin e dytë të vitit 2015. Raporti K2 2015 (Prill-Qershor) është përgatitur dhe është dërguar në MIE. Ndërsa në kuadër të Liberalizimit të Vizave, nga 14-17 korrik 2015 në janë koordinuar takimet si dhe janë dhënë komentet e kërkuara nga bartësit e veprimeve në këtë fushë. Në dhjetor janë përgatit komentet për Raportin vjetor në fushën e zbatimit të udhërrëfyesit për LV.
Me qëllim të Hartimit të PKZMSA-së, i cili është i ndarë në tri blloqe: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane, nga gjithsejtë 35 Kapituj MF është Institucion Udhëheqës për 9 Kapituj, ndërsa Institucioni Ndihmës për 9 Kapituj të tjerë. Gjatë vitit është koordinuar puna me 22 struktura të institucioneve qeveritare në nëntë GP për hartimin e PKAA-së ku MF është institucion kryesor përgjegjës. Pas publikimit të Raportit të vendit për vitin 2015, janë identifikuar sfidat. Në bashkëpunim me MIE janë dhënë komente për plotësimin e PKZMSA-së.

Gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë aktivitete në zbatimin e objektivit të dytë, koordinimin sa më të mirë të Asistencës së Jashtme në kuadër të MF-së. Është siguruar që ndihma e jashtme në prioritete dhe plane të Ministrisë. Në kuadër të programimit të projekteve për IPA II janë adresuar në MIE kërkesat për përkrahje nga IPA II, në shumë prej 4 mil. euro, në ngritjen e sistemit të ri të TI-së për ATK si pjesë e Dokumentit Sektorial Planifikues për mbështetje në sektor të konkurueshmërisë.

Në kuadër të asistencës nga TAIEX janë finalizuar dhe dërguar katër kërkesa. UNDP ka përkrah GP-në e MF në fushën e ndihmës shtetërore. Është siguruar përkrahja për hartimin e Strategjisë për MFP me ekspert nga OECD/SIGMA dhe kemi siguruar përkrahjen me projekt për Ekipin e Punës për Objektivin Strategjik III "Sistem i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje financiare për OShC-të". Në kuadër të Ekipit të III-të Punues është finalizuar Modeli për përkrahje të OSHC-ve me fonde publike.

Me qëllim të Koordinimit të procesit të planifikimit strategjik brenda MF duke adresuar prioritetet Strategjike të Qeverisë së Kosovës, si objektivë e tretë, janë ndërmarr aktivitete në GP-të për plotësim ndryshimin e legjislacionit që janë pjesë edhe e MSA-së dhe rrjedhimisht edhe interes i Komisionit Evropian.

Në muajin prill janë përgatitur dhe dërguar përgjigjet në kuadër të vlerësimit të SIGMA-s "Parimet e Administratës Publike- në fushën e Menaxhimit të Financave Publike". Ndërsa në prill dhe korrik është përgatitur raporti për zbatimin e strategjisë për Bashkëpunim të Qeverisë me OSHC gjatë tremujorit të parë dhe të dytë 2015 të cilat janë prezantuar në takimet e Këshillit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017. Në dhjetor është përgatitur Raporti Vjetor dhe është prezantuar po ashtu në takimin e Këshillit në dhjetor 2015.

Janë përgatit materialet për dy takimet e Grupit të Veçantë për RAP, të mbajtura në qershor dhe dhjetor 2015. Është themeluar Ekipi Përgjegjës (EP) për hartimin e Strategjisë për MFP, si detyrë e dalë në kuadër të shtyllës së tretë të RAP. Janë mbajtur 5 takime të EP (shtator, tetor dy takime, nëntor dhe dhjetor). Strategjia e MFP pritet të hartohet dhe aprovohet në Qeveri deri në qershor 2016. Ekipi Përgjegjës është përkrahur në punën e tij nga OECD/SIGMA.

Është hartuar Drafti final i PVPMF për vitin 2016 i cili ka shërbyer edhe për finalizimin e kontributeve të MF në tabelën A dhe B të PVPQ 2016. Pas konsultimeve me Sekretariatin Koordinues të Qeverisë janë finalizuar komentet dhe PVPQ 2016 është aprovuar.

Aktivitetet lidhur me objektivin e katërt, Monitorimi, raportimi dhe zhvillimi i Planeve vjetore të punës dhe Planeve nga Agjenda Evropiane janë të renditura më poshtë: Në fillim të periudhës raportuese është rishikuar Plani Vjetor i punës së MF (PVPMF) 2015 si dhe pjesa e kontributit të MF për Planin Vjetor të Punës së Qeverisë (PVPQ) 2015. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Progresit (PVRP) 2015 është kompletuar me kontribute nga MF dhe pas freskimit është aprovuar në Qeveri në janar 2015. Është dhënë kontribut në kuadër të Autoritetit Qeveritar për Monitorimin e lëvizjeve të Migrimit në freskimin e Profilit të Migrimit 2014.
Gjatë periudhës raportuese janë përgatitur rregullisht Raportet Mujore për zbatimin e PVPMF 2015 si dhe të PVRP 2015. Katër Raportet Tremujore për zbatimin e PVPQ 2015, PVPMF 2015, PVRP 2015 dhe zbatimit të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017 janë përgatit në afatet e parapara kohore. Në dhjetor është përgatit Raporti Vjetor përmbledhës i të arriturave në kuadër të MF. Me qëllim të avancimit të zbatimit të planeve të punës është përgatit gjithashtu analiza e sfidave të MF në zbatimin e PVRP 2015 dhe PVPMF 2015. Gjatë periudhës raportuese po ashtu kemi përgatit raportet e MF për kontributin (Inputin) II të Institucioneve të Republikës së Kosovës për Raportin e KE-së për vendin 2015 (ish-Raportin e Progresit). Raportet kanë mbuluar periudhën 1 maj – 31 gusht 2015. Gjithashtu, janë përgatitur komentet e MF për finalizimin e dy Draft analizave për zbatimin e PVPQ 2015 nga ana e Ministrive, të hartuar nga SKQ/ZKM.

Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Teknologjisë informative

Departamenti i Teknologjisë Informative ka bërë administrimin e të gjithë serverëve të MF (domen kontrollorët; fajll serverët; mail serveri; serverët për kopje rezervë; serverët e bazave të shënimeve, print serverët etj.) dhe tërë infrastrukturën e rrjetit përfshirë: antenat mikrovalore dhe wireless; swich-et; ruteret dhe sigurinë kibernetike për ndalimin e qasjeve të paautorizuara dhe mbrojtjen nga viruset.

Realizimi i këtij objektivi ka qenë jetik për funksionimin normal dhe pa ndërprerje të sistemeve të MF përfshirë: SIMFK, BDMS, PIP dhe sistemi i tatimit në pronë.
Menaxhimi dhe administrimi i serverëve dhe gjithë infrastrukturës së rrjetit është bërë në mënyrë të centralizuar përmes sistemit softuerik shumë specifik dhe efikas Vmware.

Gjatë tërë vitit infrastruktura e MF është menaxhuar dhe administruar dhe niveli i disponueshmërisë ka qenë rreth 99 % të kohës. Mbrojtja e infrastrukturës së MF nga sulmet kibernetike ka qenë në nivelin e duhur dhe asnjëherë gjatë vitit nuk ka pasur çasje të paautorizuara në infrastrukturën apo sistemet e MF.

Nga ana e Komitetit Teknik për TI janë kryer të gjitha parapërgatitjet për fillimin e projektit për integrimin e sistemit raportues të MF; zhvillimin e depos së të dhënave (datawarehause) si dhe zhvillimin e sistemit raportues analitik (Bussines Intelegence).

Aktivitetet e ndërmarra nga Komiteti Teknik me nëngrupe punuese janë, Inventarizimi i personelit kyç që do të merret me menaxhimin e projektit, Inventarizimi i të gjitha sistemeve dhe arkitektura e sistemeve në MF. Në periudhën K1 ka përfunduar specifikimi teknik dhe termat e referencës. Gjithashtu Komiteti Teknik përmes nëngrupeve punuese ka hartuar termat e referencës për implementimin e kornizës së punës ITIL dhe kemi përfituar projektin e ndihmës G2G nga USAID ku është nënshkruar kontrata dhe ka filluar zbatimi i kontratës gjithashtu, është identifikuar lokacioni për qendrën sekondare të të dhënave që do të shërbej për rimëkëmbje në rast të fatkeqësive.

Komiteti Teknik ka bërë analizën e integrimit të infrastrukturës komunikuese të TI-së së MF me Agjencinë e TI-së në MAP, ku janë mbajtur takime të përbashkëta të komitetit teknik me stafin e ASHI-së. Komiteti teknik është duke marrë pjesë aktive në hartimin e strategjisë nacionale për e-Qeverisje e udhëhequr nga ASHI.

Në data qendrën e MF është konfiguruar storage kryesor dhe tre server si dhe është testuar funksionaliteti i tyre dhe sinkronizimi me qendrën primare në MAP. Në bazë të testimeve infrastruktura sekondare është në funksion të plotë dhe e gatshme për instalimin e sistemit të e-prokurimit.
Ndër aktivitete tjera të DTI-së në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të saj gjatë vitit 2015 kanë qenë, Pjesëmarrja në zhvillimin e sistemit të TI-së për tatim në pronë Protax 2 – TI në përmbushje të marrëveshjes së MF me SIDA, Pjesëmarrja në monitorimin dhe implementimin e sistemit të e-prokurimit, DTI ka marr pjesë aktive në monitorimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të këtij sistemi si dhe në hartimin e strategjisë për reforma të financave publike.

Divizioni i Prokurimit

Divizioni për Prokurim (DP) gjatë vitit 2015 ka zhvilluar aktivitetet e prokurimit në harmoni me Ligjin e prokurimit nr.04/L-042 udhëzuesin operativ për prokurim publik, duke marr parasysh përgjegjësitë, rregulloret financiare dhe udhëzimet e Thesarit, Ligjit vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Gjatë këtij viti janar- dhjetor janë realizuar 35 procedura, duke u bazuar në kërkesat e aprovuara nga ZKA, dhe realizimi i tyre është bërë sipas planit përfundimtar. Ndërsa për programin G2G janë realizuar 5 procedura dhe 5 procedura janë në proces.
Po ashtu është bërë përgatitja e raporteve mujore, tremujore dhe raportit vjetore si dhe përgatitja e raportit në bazë të Rregullores Financiare nr.02/2013 të raportimit javor dhe mujor.

Divizioni Administrativ i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar

Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar gjatë vitit 2015 ka aprovuar plotësim/ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.2015/01 për Licencim të Auditorëve Ligjor dhe Ri licencim. Ka aprovuar U.A.02/2015 për strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare sipas SNRF-ve për NVM-të, Raportin Vjetor 2015 të Performancës së Pasqyrave Financiare të ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë.

Gjithashtu janë publikuar SNRF-të për NVM-të, sipas marrëveshjes së arritur me Fondacionin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla si dhe është bërë hartimi i draftit të projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe ka përfunduar plotësim ndryshimin duke u harmonizuar plotësisht në Direktivat Relevante të BE-së dhe rekomandimet e ROSKUT (Raporti për respektimin e Standardeve dhe Kodeve të Kontabiliteti dhe Auditimit).

Komisionet e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar dhe Auditim gjatë kësaj periudhe raportuese kanë mbajtur seancat e tyre të rregullta duke i përmbushë kërkesat e parashtruara të parapara me rregulloren e brendshme të punës së Këshillit.

Zyra për komunikim publik

Duke u bazuar në Planin e saj të punës për vitin 2015 dhe aktiviteteve të tjera shtesë, në harmoni me Planin vjetor të Punës dhe dokumenteve tjera strategjike të Ministrisë së Financave, si dhe në bashkëpunim me sektorët tjerë në kuadër të Ministrisë së Financave, Kabinetin e Ministrit dhe Zyrën e Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë, Zyra për Komunikim Publik gjatë vitit 2015 ka arritur të realizoj me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e saj dhe ti përmbush me sukses planet dhe objektivat e Ministrisë në fushën e komunikimit.

Gjatë periudhës vjetore 12.12.2014 deri më 11.12.2015 Zyra për Komunikim Publik ka hartuar dhe publikuar 126 Komunikata për Media dhe 7 demante, ka organizuar 37 konferenca për Media, 40 paraqitje publike, janë dhënë 34 intervista nga ministri Avdullah Hoti dhe zyrtarë të tjerë të MF-së si dhe janë përgatitur dhe kthyer përgjigje për mediat e shkruara dhe elektronike për tema të ndryshme në lidhje me punën e MF-së si dhe ka bërë monitorimin e mediave.

Ndërsa, sa i parket qasjes në dokumente zyrtare, në kuadër të përgjegjësive të saj Zyra për Komunikim Publik, gjatë vitit 2015 gjithashtu për qasje në dokumentet publike ka dërguar gjithsej 42 përgjigje, nga këto 11 për gazetar, 25 për shoqëri civile dhe 7 për individ.

Zyra për Komunikim publik ka qenë e angazhuar në vazhdimësi në punë dhe aktivitete të cilat kanë qenë të planifikuara si dhe në ato jashtë planit vjetor të MF-së.

Në kuadër të përgjegjësive të saj ZKP ka bërë publikimin e të gjitha materialeve në ueb faqen e Ministrisë, si dhe në rrjetet sociale “Facebook” dhe “Youtube”.



Prishtinë, 06 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës Safet Gërxhaliu.

Prishtinë, 06 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me kryetarin e Odës Ekonomike Amerikane Arian Zeka.

Prishtinë, 09 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me drejtoreshën e SHKÇAK-së Ardiana Bunjaku.

Prishtinë, 12 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me kryetarin e Aleancës Kosovare të Biznesit Agim Shahini.

Prishtinë, 13 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me Ambasadorin italian në Prishtinë Andreas Ferrarese.

Prishtinë, 13 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me ambasadoren e Zvicrës në Kosovë Krystyna Marty Lang.

Prishtinë, 15 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë/Përfaqësues i Posaçëm i BE-së Samuel Zhbogar.

Prishtinë, 15 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me ambasadoren turke në Prishtinë Songul Ozan.

Prishtinë, 15 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe Drejtoresha e Bankës Botërore për Kosovë dhe Koordinatorja Rajonale për Evropën Juglindore Ellen Goldstein, kanë nënshkruar dy projekte të reja të financuara nga Banka Botërore, Projektin për Efiçiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtëritshme në Kosovë në vlerë prej 24.3 milionë euro si dhe Projektin për Shëndetësinë në Kosovë në vlerë prej 19.95 milionë euro.

Prishtinë, 15 janar 2015 - Ministri Avdullah Hoti në takim me drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës dhe zyrtarët tjerë të lartë të këtij institucioni.

Prishtinë, 16 janar 2015 - Ministri Avdullah Hoti në vizitë Doganën e Kosovës

Prishtinë, 16 janar 2015 – Ministri Avdullah Hoti në takim me Asociacioni i Komunave të Kosovë

Prishtinë, 19 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti në tryezën e organizuar për "Programin Kombëtar për Reforma në Ekonomi".

Prishtinë, 19 janar 2015 - Ministri i Financave Avdullah Hoti, në shënimin e 15 përvjetorit të themelimit të Administratës Tatimore.

Prishtinë, 22 janar 2015 – Takimi i rregullt i Komisionit të Granteve. Në bazë të nenin 32 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Komisioni bëri përzgjedhjen e anëtarëve të rinj me short, për katër kryetarë të komunave me mandat ligjor njëvjeçar si anëtarë të Komisionit të Granteve gjatë vitit 2015.

Prishtinë, 22 janar 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në Konferencën e Nivelit të Lartë mbi Transparencën Buxhetore në Kosovë", të organizuar nga projekti i GIZ-së "Reformimi i Sistemeve të Financave Publike" në Kosovë.

Prishtinë, 30 janar 2015 – Kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, i shoqëruar nga ministri i Financave, Avdullah Hoti, në vizitë në Zyrën Regjionale të Administratës Tatimore të Kosovës në Prizren si dhe vendkalimin doganor në Vermicë.

Prishtinë, 02 shkurt 2015 – Kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, i shoqëruar nga ministri i Financave, Avdullah Hoti dhe ministri i Bujqësisë, Memli Krasniqi, ka vizituar Komunën e Rahovecit, ku janë pritur nga kryetari Idriz Vehapi, si dhe kanë qëndruar në Shtëpinë e Verës ku kanë zhvilluar një bashkëbisedim me përfaqësues të Shoqatës së Përpunuesve të verës në këtë Komunë.

Prishtinë, 03 shkurt 2015 – Kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa, i shoqëruar nga ministri i Financave, Abdullah Hoti dhe ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami, në vizitë në Komunën e Ferizajt, ku janë pritur nga kryetari i Komunës, Muharrem Svarqa dhe kanë zhvilluar një bashkëbisedim përmbajtjesor me përfaqësues të bizneseve që operojnë në Ferizaj.

Prishtinë, 04 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me Komisionin e Arkave Fiskale.

Prishtinë, 05 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti, në konferencë për media për vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Komisionit Ekzekutiv për shqyrtimin e mundësisë për faljen e borxheve të personave fizik dhe juridik, ndaj institucioneve shtetërore dhe ndaj ndërmarrjeve publike në Republikën e Kosovës, deri më 31 dhjetor 2008.

Prishtinë, 06 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim ambasadoren e Finlandës në Prishtinë Anne Meskanen.

Prishtinë, 06 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe zëvendësministri i Financave Agim Krasniqi në Konferencë për Media, në lidhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për faljen e borxheve të personave fizik dhe juridik, ndaj institucioneve shtetërore dhe ndaj ndërmarrjeve publike në Republikën e Kosovës.

Prishtinë, 09 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me ambasadoren gjermane në Prishtinë Angelika Viets.

Prishtinë, 11 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me Odat Ekonomike dhe përfaqësues të bizneseve për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale.

Prishtinë, 16 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me ambasadoren e Francës në Kosovë Maryse Daviet.

Prishtinë, 21 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti gjatë vizitë zyrtare në Slloveni, është takuar me Ministrin e Financave të Sllovenisë, Dušan Mramor dhe zyrtarë të lartë të shtetit slloven.

Prishtinë, 24 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim një delegacion të BERZH-it të kryesuar nga Drejtoresha e Transportit Sue Barrett.

Prishtinë, 26 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Tracey Ann Jacobson, kanë nënshkruar marrëveshjen FATCA, (Foreign Acount Tax Compliance Act - Ligji për Pajtueshmërinë mbi Tatimin e Llogarive të Jashtme të SHBA-Së).

Prishtinë, 26 shkurt 2015 – Ministri i Financave Avdullah në takim një delegacionin të Qeverisë Gjermane, të kryesuar nga Dirk Schattschneider, Shef i Divizionit të Evropës Jug-Lindore dhe Kaukaz BMZ, Henriette Kotter, Sekretarja e parë, Simona Ëunsch BMZ, Gravenkoter KfW si dhe James Macbeth GIZ.

Prishtinë, 03 mars 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti, gjatë vizitës zyrtare në Shqipëri është takuar me homologun e tij ministrin e Financave Shkëlqim Cani.

Prishtinë, 04 mars 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti, në Konferencë për Media, duke prezantuar punën e Komisionit për faljen e borxheve dhe për aprovim edhe projektligjin për faljen e borxheve.

Prishtinë, 06 mars 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti gjatë fjalimit të tij në takimin e Qeverisë me Ambasadorë dhe Përfaqësues të Agjencive zhvillimore.

Prishtinë, 11 mars 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti, gjatë vizitës zyrtare në Austri, u takua me Ministrin e Financave të Austrisë Hans J⊠rg Schelling dhe zyrtarë të lartë të shtetit të Austrisë.

Prishtinë, 12 mars 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim Zëvendëspresidenten rajonale të Bankës Botërore znj. Laura Tuck, e shoqëruar nga drejtoresha Rajonale e Bankës Botërore znj. Ellen Goldstein, si dhe Menaxheri i Bankës Botërore për Kosove z. Jan-Peter Olters.

Prishtinë, 13 mars 2015 – Debati publik i organizuar nga Ministria e Financave lidhur me ndryshim - plotësimet e projektligjeve: Projektligji për TVSH (Tatimi mbi vlerën e shtuar), Projektligji për TAP (Tatimi në të ardhurat personale), si dhe Projektligji për TAK (Tatimi në të ardhurat e korporatave).
Në këtë debat publik murrën pjesë Ministri i Financave Avdullah Hoti, Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Memli Krasniqi, Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë Hykmete Bajrami, përfaqësuesit nga Komuniteti i Biznesit, përfaqësuesit e Shoqërisë civile si dhe Kryesuesit e grupeve punuese .

Prishtinë, 13 mars 2015 – Me ftesë të Ministrit të Financave Avdullah Hoti, u mbajt takimi i Komitetit për Partneritet Publiko Privat (PPP). Në takim ishin prezentë anëtarët e Komitetit për Partneritet Publiko Privat të emëruar nga Qeveria e Kosovës.

Prishtinë, 18 mars 2015 – Takimi i Komisionit Ndërministror për faljen e borxheve publike.

Prishtinë, 19 mars 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim delegacionin e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të kryesuar nga z. Jacques Miniane, me rastin e fillimit të vizitës së tyre në Kosovë.

Prishtinë, 20 mars 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në Konferencë për Media ku ka prezantuar para mediave Udhëzimin e ri Administrativ për Arkat Fiskale.

Prishtinë, 30 mars 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti, udhëheqësi i Misionit të FMN-së Jacques Miniane dhe guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës Bedri Hamza, në Konferencë për Media me rastin e përfundimit të vizitës së misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Kosovë.

Prishtinë, 02 prill 2015 – Zëvendësministri i Financave Agim Krasniqi në takim me Zëvendësministren e Financave të Shqipërisë Irena Beqiraj.

Prishtinë, 03 prill 2015 – Ministri Avdullah Hoti në takim me Grupin këshillëdhënës për tatime dhe dogana për Ministrin Hoti.

Prishtinë, 07 prill 2015 – Takimi i Komitetit për Partneritet Publiko Privat, në të cilin u miratua projekt-propozimin nga Kuvendi Komunal i Prizrenit për "Tregjet e Qytetit të Prizrenit".

Prishtinë, 08 prill 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe drejtori menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës Arben Gjukaj, nënshkruan Marrëveshjen për Ri-Programimin e Kredive të KEK-ut.

Prishtinë, 10 prill 2015 – Me ftes të Ministrit të Financave Avdullah Hoti është mbajtur takimi i parë informues për detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit të Granteve për vitin 2015 si dhe për procesin e planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2016.

Prishtinë, 24 prill 2015 – Me ftesë të Ministrit të Financave Avdullah Hoti, u mbajt takimi i Komisionit të Granteve për procesin e planifikimit

Prishtinë, 24 prill 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës Bedri Hamza, në Konferencë për Media për takimet pranverore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, në Uashington

Prishtinë, 26 prill 2015 – Ministri i Financave së Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti dhe Ministri i Ekonomisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, Sultan bin Saeed Al Mansouri , duke nënshkruar Marrëveshjen për Bashkëpunim Ekonomik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe.

Prishtinë, 29 prill 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në Konferencë për Media, me rastin e aprovimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për periudhën 2016 – 2018.

Prishtinë, 12 Maj 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti së bashku me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale Arban Abrashi kanë pritur në takim me përfaqësuesit e Lidhjes së Organizatave komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 15 Maj 2015 – Një delegacion i Republikës së Kosovës i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, i kryesuar nga Ministri i Financave z. Avdullah Hoti ka marrë pjesë në takimet e rregullta vjetore të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), të cilat janë mbajtur në Tbilisi të Gjeorgjisë.

Prishtinë, 15 Maj 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takimet e rregullta vjetore të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në Tbilisi të Gjeorgjisë ku është takuar edhe me presidentin e BERZH-ës z.Suma Chakrabati, drejtorët e Konstituencës për Kosovë z. Sean Donald dhe z. Ove Jensen, me drejtorin Rajonal të BERZH-ës z. Massa Bernucci, si dhe me shefen e operacioneve të OFID-it znj. Anajulia Taylhardat.

Prishtinë, 18 Maj 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë Ruairí O'Connell.

Prishtinë, 21 Maj 2015 – Konferenca për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, e organizuar nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Evropian në Prishtinë. Ku morën pjesë Agim Krasniqi Zëvendësministër i Financave, z. Raymond Hill këshilltar i kontrollit të brendshëm në DP të Buxhetit, Komisioni Evropian, Bruksel z. Thomas Gnocchi, kryesues i sektorit politik, ekonomik dhe integrimit evropian, Zyra e BE-së në Kosovë, si dhe përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Prishtinë, 26 Maj 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti ka pritur në takim zëvendësdrejtorin menaxhues të Fondit Monetar Ndërkombëtar(FMN) z. Min Zhu, njëherit kjo ishte edhe vizita e nivelit më të lartë të FMN-së që e viziton Republikën e Kosovën.

Prishtinë, 27 Maj 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe zëvendësdrejtori menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar(FMN) z. Min Zhu, në Konferencë për Media.

Prishtinë, 27 Maj 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim me Ministrin për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Republikës Federale të Gjermanisë Gerd Müller, Me këtë rast, Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe ministri për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim të Republikës Federale të Gjermanisë Gerd Müller, gjithashtu nënshkruan edhe protokollin për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë.

Prishtinë, 01 Qershor 2015 – Pranim dorëzimi i detyrës së drejtorit të Administratës Tatimore të Kosovës nga Behxhet Haliti te Nahit Sharku, i cili njëherit ka qenë zëvendësdrejtor i ATK-së.

Prishtinë, 04 Qershor 2015 – Në Odën Ekonomike të Kosovës u nënshkrua Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin. Marrëveshja u nënshkrua nga ministri i Financave Avdullah Hoti dhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë Ruairí O'Connell, ndërsa pjesëmarrës në këtë ceremoni ishte edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës Safet Gërxhaliu.

Prishtinë, 09 Qershor 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti, udhëheqësi i Misionit të FMN-së Jacques Miniane, përfaqësues rezident i Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovë Frank Lajkwik, si dhe guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës Bedri Hamza në Konferencë për Media, me rastin e përfundimit të vizitës së misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar në Kosovë.

Prishtinë, 10 Qershor 2015 – Një delegacion i Ministrisë së Financave i përbërë nga përfaqësues të Administratës Tatimore dhe Doganave në vizitë në Republikën e Sllovenisë, ku janë pritur nga Administrata Financiare e Republikës së Sllovenisë.

Prishtinë, 12 Qershor 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti, në Samitin e Ministrave të Financave dhe Guvernatorëve "E ardhmja financiare e rajonit", që po është mbajtur në Beçiq të Malit të Zi.

Prishtinë, 29 Qershor 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në takim njoftues përfaqësuesin e ri të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovë Ruud Vermeulen, i cili nga korriku i vitit 2015 ka zëvendësuar paraardhësin e tij përfaqësuesin e FMN-së në Kosovë Frank Lajkwik, i cili gjithashtu ishte i pranishëm në këtë takim.

Prishtinë, 03 Korrik 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti së bashku me bashkëpunëtorët e tij ka pritur në vizitë zyrtare një delegacion të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë të kryesuar nga Ministri i Financave Shkëlqim Cani.

Prishtinë, 06 Korrik 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në vizitë zyrtare në Zyrat regjionale të Administratës Tatimore të Kosovës në Ferizaj dhe Gjilan. Gjatë kësaj vizite ministri Hoti së bashku me drejtorin e ATK-së kanë zhvilluar takim edhe me kryetarin e komunës së Gjilanit Lutfi Hazirin.

Prishtinë, 07 Korrik 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe përfaqësuesi rezident i Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovë Frank Lajkwik në Konferencë për Media.

Prishtinë, 13 Korrik 2015 – Zëvendësministri i Financave Agim Krasniqi në takim me përfaqësuesit e bizneseve

Prishtinë, 14 Korrik 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti ka pritur në vizitë drejtorët e Konstituencës për Kosovë në Bankën për Zhvillim dhe Rindërtim (BERZH) z.Ove Jensen dhe z. Sean Donlon.

Prishtinë, 14 Korrik 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti në vizitë Zyrën regjionale të Administratës Tatimore të Kosovës në Prizren.

Prishtinë, 25 Gusht 2015 – Forumin me autoritetet komunale dhe qendrore për zhvillimin e procesit buxhetor komunal për vitin 2016-2018, si pjesë e projektit "Mbështetje dialogut në mes të nivelit qendror dhe atij lokal për një reformë efektive të qeverisjes lokale", e organizuar nga Ministria e Financave (MF) në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së.

Prishtinë, 27 Gusht 2015 – Takimi Konsultativ me palët e interesit i organizuar nga Ministria e Financave, me qëllim të diskutimit të Pakos së re fiskale të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si: Ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Ligjin për Tatimin në të Ardhura Personale, si dhe Ligjin për Tatimin në të Ardhura të Korporatave, e cila pako ka filluar së zbatuari nga 1 shtatori 2015.

Prishtinë, 28 Gusht 2015 – Në Ministrinë e Financave u mbajt takimi i Grupit Punues Qeveritar për Strategjinë kombëtare për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare (2014-2018), i cili u kryesua nga zëvendësministri i Ministrisë së Financave Agim Krasniqi.

Prishtinë, 31 Gusht 2015 – Ministri i Financave Avdullahu Hoti në takim kurtuazie me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë Greg Delawie.

Prishtinë, 04 Shtator 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti dhe zëvendëspresidenti i parë i BERZH-it Phil Bennett, kanë nënshkruar Marrëveshjen për projektin "Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10", për modernizimin e infrastrukturës hekurudhore të Kosovës.

Prishtinë, 08 Shtator 2015 – Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria Federale e Republikës së Gjermanisë kanë nënshkruar Marrëveshjet për bashkëpunim financiar për vitin 2014. Marrëveshjet u nënshkruan nga ministri i Financave Avdullah Hoti dhe ambasadorja e Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë znj. Angelika Viets.

Prishtinë, 10 Shtator 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti ka pritur në takim anëtaren e Bordit të Drejtorëve Ekzekutiv të Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) Ingrid Hengster.

Prishtinë, 12 Shtator 2015 – Ministri i Financave Avdullah Hoti ka marrë pjesë në ceremoninë tradicionale të shpërblimit të tatimpaguesve të vitit, të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganën e Kosovës organizuan.

Prishtinë, 29 Shtator 2015 – Ministria e Financave gjegjësisht Departamenti i Tatimit në Pronë së bashku me USAID-in dhe SDC-në kanë organizuar seminarin treditorë në lidhje me procedurat për faljen e borxheve publike.